



**UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA"
UNIVERSITY**

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e
Kosovës www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

**RAPORT PËRMBLEDHËS PËR VLERËSIM TË STAFIT AKADEMIK SI DHE LËNDËVE
NGA STUDENTËT E UNIVERSITETIT 'KADRI ZEKA', PËR SEMESTRIN VEROR TË
VITIT 2018/2019**

Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi
Fitore Malaj-Abdyli

Përmbajtja

Hyrje	3
1. Metodologjia e hulumtimit.....	4
1.1. Qëllimi i hulumtimit	4
1.2. Metodatat e hulumtimit.....	4
2. Rezultatet e Hulumtimit	5
2.1. Informata për rrjedhën e hulumtimit	5
2.2. Analiza e pyetësorëve	6
Tabela 1. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike për Profesor	6
Tabela 2. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike për Asistentë	7
Tabela 3. Fakulteti Ekonomik për Profesor	8
Tabela 3.1 Fakulteti Ekonomik për Asistentë	8
Tabela 4. Fakulteti Juridik për Profesor.....	10
Tabela 4.1 Fakulteti Juridik për Asistentë	10
Tabela 5. Fakulteti i Edukimit për Profesor	11
Tabela 5.1 Fakulteti i Edukimit për Asistentë.....	12
Tabela 6. Fakulteti Juridik – Programi Master E-Qeverisja	13
Tabela 7. Rezultatet e përgjithshme të vlerësimit të Stafit Akademik të UKZ-së nga ana e studentëve	15
Tabela 7.1 Për Asistentë	15
3. Përfundimet dhe rekomandimet	17

Hyrje

Duke u bazuar në Rregulloren për Procedurat e Sigurimit të Cilësisë (Ref.nr.01/380 dt. 10/05/2016) si dhe Udhëzuesin për Vlerësimin e Stafit Akademik dhe lëndëve nga studentët e UKZ-ë (Ref.nr.01/198 dt. 04.03.2019) është realizuar Vlerësimi i Stafit Akademik nga studentët për Semestrin Veror 2018/2019 në Universitetin “Kadri Zeka”, të dytin me radhë brenda Vitit Akademik 2018/2019.

Duke marrë parasysh rëndësinë e organizimit të mësimin nëpër Njësitë Akadematike të Universitetit, Zyra jonë në bashkëpunim me Komisionin për Sigurim të Cilësisë ka organizuar hulumtimin me studentë të UKZ-së.

Në kuadër të kësaj kemi hartuar pyetësin të bazuar në cilësinë e mësimdhënies, i cili kësaj radhe ka qenë i ndarë ndërmjet Profesorit dhe Asistentit, duke na u dhënë rasti që të dhënat të trajtohen në aspekte më të detajuara. Me anë të pyetësorëve ne kemi bërë matjen e realizimit të detyrave dhe përgjegjësisve të profesorit karshi studentit si dhe përputhshmërinë e Asistentit me Profesorin, si në aspektin metodologjik po ashtu edhe në aspektin përmbajtësor.

Gjithashtu pyetësi ka përmbajtur edhe hapësirën për komente, ku studentët kanë pasur rastin të shprehin më gjerësisht mendimet e tyre.

1. Metodologjia e hulumtimit

1.1. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi ka të bëjë me identifikimin e problematikave të mundshme gjatë realizimit të plan programeve mësimore të mësimdhënësve në UKZ, përgjegjshmërinë e Stafit Akademik karshi trajtimit të lëndëve si dhe qasjen në përgjithësi të obligimeve që mësimdhënësi ka ndaj lëndës dhe studentit duke fokusuar edhe literaturën që ofrojnë si dhe lidhshmërinë që ka Profesori me Asistentin në organizimin e ligjëratave dhe ushtrimeve.

Nga ky hulumtim kemi arritur të nxjerrim vlera të cilat përcaktojnë shkallën e veprimit të mësimdhënësve brenda angazhimit të tyre profesional nëpër lëndë të caktuara të Programeve Studimore brenda Universitetit.

Rekomandimet e dala nga ky vlerësim do t'u shërbejnë Stafit Akademik si dhe menaxhmentit të lartë të UKZ-së për të reflektuar mbi gjetjet e hulumtimit për periudhën e Semestrit Veror 2018/2019.

1.2. Metodatat e hulumtimit

Hulumtimi u realizua kryesisht përmes metodës kuantitative dhe instrumenteve që janë në funksion të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave.

Shpërndarja e pyetësorëve

Meqenëse objekt hulumtimi ishin tetë Programet Studimore (studime të dy niveleve) atëherë shpërndarja e pyetësorit u bë në të gjitha Njësitë Akadematike të Universitetit, gjatë periudhës 23 -29 Maj të vitit 2019. Me lejen e profesorëve shpërndarja e pyetësorëve u bë gjatë orarit të ligjëratave dhe u realizua për një javë.

2. Rezultatet e Hulumentimit

2.1. Informata për rrjedhën e hulumentimit

Në kuadër të punëve të Zyrës Për Zhvillim Akademik dhe Cilësi (ZZHA) është paraparë që pas çdo Semestri të bëhet vlerësimi nga ana e studentëve, kështu që në bashkëpunim me Menaxhmentin e Lartë të UKZ-së si dhe Komisionin për Sigurimin e Cilësisë kemi hartuar pyetësin sipas Shkallës së Likertit, ku studenti për secilin konstatim është dashur të rrumbullakojë 1,2,3,4 ose 5 (5=pajtohem plotësisht; 4=pajtohem; 3=nuk e di; 2=nuk pajtohem; 1=aspak nuk pajtohem).

Për të realizuar hulumentimin kemi caktuar një Grup Punues prej 8 anëtareve nga administrata, si dhe 4 studentë nga Parlamenti Studentor, të cilët kanë qenë përgjegjës në shpërndarjen e pyetësorëve nëpër të gjitha NJA të UKZ-së .

Studentët e UKZ-së kanë plotësuar 4228 pyetësor gjithsej.

Në regjistrimin e të dhënave të pyetësorëve në formë elektronike, Zyrën për Zhvillim Akademik e ndihmuan grupi i studentëve.

Me vendim të Komisionit për Sigurim të Cilësisë, bazuar në Udhëzuesin për Vlerësim të Stafit Akademik si dhe lendeve nga studentet (Pika 5), të gjithë mësimdhënësve të UKZ-së (Profesor dhe Asistentë), rezultati i vlerësimit iu është dorëzuar në mënyrë individuale, në formë elektronike.

Për hartimin e Raportit të Vetëvlerësimit si dhe publikimin e rezultateve ka punuar kryesisht Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi në konsultim me Komisionin për Sigurimin e Cilësisë.

2.2 Analiza e pyetësorëve

2.1.1. Qëndrimet e studentëve të Njësive Akademike në raport me pohimet e shprehura në pyetësor

Tabela 1. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike për Profesor

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Syllabusi i lëndës është prezantuar në fillim të semestrit	4.40
2	Mësimdhënësi /ja ka qenë i rregullt dhe ka ardhur në kohë gjatë ligjëratave	4.19
3	Mësimdhënësi ka ardhur i përgatitur në mësim	4.55
4	Mësimdhënësi/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.29
5	Mësimdhënësi/ja ka shpjeguar mire konceptet e reja	4.47
6	Literatura e ofruar nga mësimdhënësi/ja është e mjaftueshme për përvetësimin e lëndës	4.25
7	Materialet mësimore kanë qenë të dobishme për studimet e mia	4.34
8	Vlerësimi i punës së studentëve është bërë në vazhdimësi	4.19
9	Konsideroj se vlerësimi nga ana e mësimdhënësit është real	4.49
10	Mësimdhënësi/ja ka mbajtur konsultime të rregullta	4.49
Mesatarja e përgjithshme		4.37

Tabela 2. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike për Asistentë

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Asistenti/ja ka qenë i/e rregullt dhe ka ardhur në kohë gjatë ushtrimeve	4.29
2	Asistenti/ja ka ardhur i/e përgatitur në mësim	4.36
3	Asistenti/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.08
4	Asistenti/ja ka shpjeguar mire konceptet e reja	4.16
5	Materialet mësimore kanë qenë të dobishme për studimet e mia	4.09
6	Vlerësimi i punës së studentëve është bërë në vazhdimësi	3.94
7	Konsideroj se ushtrimet kanë qenë të dobishme për lëndën	4.22
8	Ushtrimet e Asistentit/ës janë në përputhje të plotë me ligjëratat e Profesorit	4.30
	Mesatarja e përgjithshme	4.18

Tabela 5 pasqyron qëndrimet e studentëve të Shkencave Kompjuterike ndaj profesorëve të tyre.

Nga studentët janë kërkuar përgjigje në pohimet e parashtruara sipas shkallës së Likertit (nga 1- 5) . Në përgjigjet e dhëna shihet se nuk ka dallime esenciale në qëndrimet e studentëve. Në konstatimet 3,5,10, ku flitet për përgatitjen e mësimeve për mësim, qartësinë gjatë shpjegimit, vlerësimin real nga ana e mësimeve, si dhe mbajtjen e konsultimeve të rregullta, studentët kanë vlerësuar në një shkallë të lartë (mesatarja 4.47 deri 4.55). Gjithashtu në pohimet 2,4,6,7, dhe 8. Shihet një ulje e lehtë në përqindje lidhur me pjesëmarrjen e rregullt të profesorëve në ligjëratat, kreativitetin e mësimeve, materialet mësimore si dhe vlerësimi në vazhdimësi i studentit, (mesatarja 4.19 deri 4.34) Mesatarja e përgjithshme në FSHA është mjaft e kënaqshme (saktësisht 4.37)

Një ulje më e theksuar vërehet tek qëndrimet e studentëve karshi asistentëve,(Tabela 5.1) ku mesatarja më e lartë është 4.36, në konstatimin se asistentët janë të rregullt në ushtrime, kurse me shkallë më të ulët të vlerësimit (3.94) janë shprehur lidhur me vlerësimin e punës së studentëve. Në pohimet 1, 4, 7, 8 qëndrimet e studentëve përafërsisht janë të përafërta njëra me tjetrën, me dallime të vogla në përqindje. Një

vlerësim më i ultë shihet tek pohimi 3 ku studentët shprehen më pak më të kënaqur lidhur me kreativitetin e asistentëve në organizimin e ushtrimeve (4.08). Vlen të theksohet se përqindja e vlerësimit për Profesor është me e lartë se përqindja e vlerësimit për Asistentë. (4.37 me 4.18)

Tabela 3. Fakulteti Ekonomik për Profesor

POHIMET	Vlera Mesatare
1 Syllabusi i lëndës është prezantuar në fillim të semestrit	4.64
2 Mësimdhënësi /ja ka qenë i rregullt dhe ka ardhur në kohë gjatë ligjëratave	4.44
3 Mësimdhënësi ka ardhur i përgatitur në mësim	4.59
4 Mësimdhënësi/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.03
5 Mësimdhënësi/ja ka shpjeguar mire konceptet e reja	4.31
6 Literatura e ofruar nga mësimdhënësi/ja është e mjaftueshme për përvetësimin e lëndës	4.21
7 Materialet mësimore kanë qenë të dobishme për studimet e mia	4.26
8 Vlerësimi i punës së studentëve është bërë në vazhdimësi	4.02
9 Konsideroj se vlerësimi nga ana e mësimdhënësit është real	4.27
10 Mësimdhënësi/ja ka mbajtur konsultime të rregullta	4.27
Mesatarja e përgjithshme	4.30

Tabela 3.1 Fakulteti Ekonomik për Asistentë

POHIMET	Vlera Mesatare
1 Asistenti/ja ka qenë i/e rregullt dhe ka ardhur në kohë gjatë ushtrimeve	4.62
2 Asistenti/ja ka ardhur i/e përgatitur në mësim	4.42
3 Asistenti/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.37
4 Asistenti/ja ka shpjeguar mire konceptet e reja	4.24

5	Materialet mësimore kanë qenë të dobishme për studimet e mia	4.26
6	Vlerësimi i punës së studentëve është bërë në vazhdimësi	4.16
7	Konsideroj se ushtrimet kanë qenë të dobishme për lëndën	4.34
8	Ushtrimet e Asistentit/ës janë në përputhje të plotë me ligjëratat e Profesorit	4.32
	Mesatarja e përgjithshme	4.34

Qëndrimet e përgjithshme të studentëve të Fakultetit Ekonomik për Staf Akademik janë paraqitur në tabelën 6.

Në pohimet 1 dhe 3, të kësaj table, të dhënat na tregojnë se studentët kanë vlerësuar me një përqindje të përafërt Profesorët e tyre si në shpërndarjen e syllabusit në fillim të semestrit, po ashtu në përgatitjen e duhur të tyre për orë mësimore (4.64 - 4.59). Qëndrime të përafërta studentët shprehin edhe në pohimet 2 dhe 5 lidhur me vijimin e rregullt të profesorëve (4.44) si dhe në shpjegimin e koncepteve të reja. Në konstatimet 7, 9 dhe 10 qëndrimet e studentëve karshi materialeve të duhura që përdorin profesorët me studentë, vlerësimin real që bëjnë ata si dhe mbajtjen e rregullt të konsultimeve (4.26, 4.27, 4.27)

Një ulje në përqindje shihet tek pohimet 4 dhe 8 , ku studentët shprehen me pak të kënaqur në nxitjen e diskutimeve dhe aktiviteteve gjatë ligjëratave, si dhe praktikave të vlerësimit. (4.03 dhe 4.02)

Mesatarja e përgjithshme e Profesorëve të Fakultetit Ekonomik është 4.30

Në tabelën 6.1 kemi veçuar qëndrimet e studentëve për Asistentë. Vlerat e shprehura në mesatare nuk kanë dallime të mëdha ndërmjet pohimeve. Studentët shprehen të kënaqur në përgjithësi, me mesatare më të lartë kanë vlerësuar vijueshmërinë e asistentëve (4.62), ndërsa pohimet tjera sillen prej 4.16 e deri në 4.42.

Mesatarja e përgjithshme e Asistentëve të Fakultetit Ekonomik, me një dallim të vogël në përqindje është pak më e lartë,

Tabela 4. Fakulteti Juridik për Profesor

POHIMET	Vlera Mesatare
1 Syllabusi i lëndës është prezantuar në fillim të semestrit	4.57
2 Mësimdhënësi /ja ka qenë i rregullt dhe ka ardhur në kohë gjatë ligjëratave	4.39
3 Mësimdhënësi ka ardhur i përgatitur në mësim	4.50
4 Mësimdhënësi/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.25
5 Mësimdhënësi/ja ka shpjeguar mire konceptet e reja	4.41
6 Literatura e ofruar nga mësimdhënësi/ja është e mjaftueshme për përvetësimin e lëndës	4.35
7 Materialet mësimore kanë qenë të dobishme për studimet e mia	4.39
8 Vlerësimi i punës së studentëve është bërë në vazhdimësi	4.33
9 Konsideroj se vlerësimi nga ana e mësimdhënësit është real	4.31
10 Mësimdhënësi/ja ka mbajtur konsultime të rregullta	4.38
Mesatarja e përgjithshme	4.39

Tabela 4.1 Fakulteti Juridik për Asistentë

POHIMET	Vlera Mesatare
1 Asistenti/ja ka qenë i/e rregullt dhe ka ardhur në kohë gjatë ushtrimeve	4.59
2 Asistenti/ja ka ardhur i/e përgatitur në mësim	4.73
3 Asistenti/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.54
4 Asistenti/ja ka shpjeguar mire konceptet e reja	4.72
5 Materialet mësimore kanë qenë të dobishme për studimet e mia	4.54
6 Vlerësimi i punës së studentëve është bërë në vazhdimësi	4.45
7 Konsideroj se ushtrimet kanë qenë të dobishme për lëndën	4.71
8 Ushtrimet e Asistentit/ës janë në përputhje të plotë me ligjëratat e Profesorit	4.71
Mesatarja e përgjithshme	4.62

Në tabelën 7, përkatësisht në pohimet 1,3,5, shihet se një numër i konsiderueshëm i studentëve të Fakultetit Juridik vlerësojnë angazhimin e mësimeve si në shpërndarjen në kohë të plan programit mësimor (4.57), në përgatitjen profesionale të mësimeve (4.50) po ashtu edhe në shpjegimin e qartë të koncepteve të reja (4.41).

Në pohimet 2, 6, 7, 8, 9,10 të anketuarit, janë përgjigjur përfaqësisht njëjtë, me një dallim të vogël të shprehur në përqindje, duke vlerësuar angazhimin e mësimeve kënaqshëm, në vijimin e rregullt të mësimeve në ligjëratat, mënyrën e vlerësimit, si dhe përmbajtjen e materialeve në dobi të tyre me mesatarja nga 4.31 gjer më 4.39.

Me një përqindje më të ulët (4.25) studentët janë shprehur më pak të kënaqur në konstatimin 4, lidhur me kreativitetin e profesorëve gjatë ligjëratave.

Mesatarja e përgjithshme e Profesorëve të Fakultetit Juridik është 4.39

Mesataren më të lartë e shohim tek vlerësimi që i është bërë Asistentëve nga ana e studentëve. Në të gjitha konstatimet e pyetësorit rezultatet e vlerësimit janë mbi 4.5.

Studentët janë të kënaqur me përgatitjen e asistentëve për ushtrime (4.73), si dhe në shpjegimin e qartë të koncepteve të reja (4.72). Gjithashtu në pohimin se ushtrimet e asistentëve janë në përputhje të plotë me ligjëratat e profesorëve si dhe ushtrimet i konsiderojnë të dobishme për studimet e tyre (4.71)

Mesatarja e përgjithshme për vlerësim të Asistentëve në Fakultetin Juridik është mjaft e lartë, 4.62.

Tabela 5. Fakulteti i Edukimit për Profesor

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Syllabusi i lëndës është prezantuar në fillim të semestrit	4.69
2	Mësimeve /ja ka qenë i rregullt dhe ka ardhur në kohë gjatë ligjëratave	4.52
3	Mësimeve ka ardhur i përgatitur në mësim	4.65
4	Mësimeve/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.13
5	Mësimeve/ja ka shpjeguar mire konceptet e reja	4.49

6	Literatura e ofruar nga mësimdhënësi/ja është e mjaftueshme për përvetësimin e lëndës	4.35
7	Materialet mësimore kanë qenë të dobishme për studimet e mia	4.36
8	Vlerësimi i punës së studentëve është bërë në vazhdimësi	4.06
9	Konsideroj se vlerësimi nga ana e mësimdhënësit është real	4.21
10	Mësimdhënësi/ja ka mbajtur konsultime të rregullta	4.20
	Mesatarja e përgjithshme	4.37

Tabela 5.1 Fakulteti i Edukimit për Asistentë

POHIMET	Vlera Mesatare
1 Asistenti/ja ka qenë i/e rregullt dhe ka ardhur në kohë gjatë ushtrimeve	4.81
2 Asistenti/ja ka ardhur i/e përgatitur në mësim	4.72
3 Asistenti/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.48
4 Asistenti/ja ka shpjeguar mire konceptet e reja	4.51
5 Materialet mësimore kanë qenë të dobishme për studimet e mia	4.45
6 Vlerësimi i punës së studentëve është bërë në vazhdimësi	4.55
7 Konsideroj se ushtrimet kanë qenë të dobishme për lëndën	4.65
8 Ushtrimet e Asistentit/ës janë në përputhje të plotë me ligjëratat e Profesorit	4.59
Mesatarja e përgjithshme	4.59

Në tabelë 8, janë analizuar të dhënat e përgjithshme të Fakultetit të Edukimit. Vlen të theksohet se qëndrimi i studentëve karshi shpërndarjes së syllabusit, vijimit të rregullt të ligjëratave nga ana e profesorëve si dhe përgatitjen e duhur për ligjëratat në këtë Fakultet (Pohimi 1,2,3) shprehet në një shkallë të lartë vlerësimi (mesatarja 4.69,4.52, 4.65). Gjithashtu numër i madh i studentëve me notë 4.49, 4.35 dhe 4.36 vlerësojnë shpjegimin e mësimdhënësve të tyre gjatë ligjëratave (pohimi 5), Shfrytëzimi i literaturës adekuate si dhe përdorimi i materialeve mësimore (Pohimi 6 dhe 7). Me një diferencë e të vogël në përqindje studentët shprehen më pak të kënaqur lidhur me inkurajimin e diskutimeve dhe

aktivitete në klasë (Pohimi 4, e shprehur me mesatare 4.13), Në pohimin 8, Vlerësimi i studentëve është bërë në vazhdimësi është shprehur me mesataren më të ulët 4.06, Kurse sa janë real mësimdhënësit në vlerësim, studentët vlerësojnë me notë 4.21 (Pohimi 9). Gjithashtu në pohimin 10, studentët kanë vlerësuar 4.20 mbajtjen e konsultimeve të rregullta.

Mesatarja e përgjithshme për profesor të Fakultetit të Edukimit është 4.37

Në tabelën 8.1 janë shprehur me mesatare qëndrimet e studentëve të Fakultetit të Edukimit për Asistentë ku shihet një ngritje më e theksuar në vlerësim. Vlen të theksohet se në shumicën e pohimeve studentët janë shprehur të kënaqur me Asistentët e tyre, kjo shihet në konstatimet 1,2,4,6,7 dhe 8, Vlerat e shprehura në mesatare janë të përafërta dhe mbi 4.5, ato variojnë nga

4.51 gjer më 4. 81. Në pohimin 5 materialet mësimore kanë qenë të dobishme për studimet e mia studentët kanë vlerësuar me 4.45 kurse në pohimin 3 lidhur me inkurajimin e diskutimet dhe aktivitetet në klasë studentët kanë vlerësuar 4.48.

Mesatarja e përgjithshme e Asistentëve të Fakultetit të Edukimit ka dukshëm një përqindje më e lartë, 4.59.

Tabela 6. Fakulteti Juridik – Programi Master E-Qeverisja

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Syllabusi i lëndës është prezantuar në fillim të semestrit	4.03
2	Mësimdhënësi /ja ka qenë i rregullt dhe ka ardhur në kohë gjatë ligjëratave	4.18
3	Mësimdhënësi ka ardhur i përgatitur në mësim	4.11
4	Mësimdhënësi/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.40
5	Mësimdhënësi/ja ka shpjeguar mire konceptet e reja	4.49
6	Literatura e ofruar nga mësimdhënësi/ja është e mjaftueshme për përvetësimin e lëndës	3.99
7	Materialet mësimore kanë qenë të dobishme për studimet e mia	4.04
8	Vlerësimi i punës së studentëve është bërë në vazhdimësi	3.95

9	Konsideroj se vlerësimi nga ana e mësimit është real	4.29
10	Mësimit/ja ka mbajtur konsultime të rregullta	4.02
	Mesatarja e përgjithshme	4.15

Në tabelën 10 kemi paraqitur rezultatet e vlerësimit të studentëve për Profesorë të programit Master.

Qëndrimet e studentëve për Programin E-Qeverisja janë shprehur me mesatare më të ulët se 4.5.

Mesatare të përafërt kanë pohimet 1,7 dhe 10. Në konstatimin se Syllabusi është shpërndarë në kohë, studentët kanë vlerësuar me notë 4.03. Studentët me notë 4.04 vlerësojnë si të dobishme për studimet e tyre përdorimin e materialeve gjatë ligjëratave, si dhe me 4.02 vlerësojnë mbajtjen e konsultimeve të rregullta nga ana e profesorëve.

Diferenca me një përqindje të vogël shprehet edhe tek vlerat e pohimeve 2,3 dhe 9. Studentët qëndrimin e tyre se a kanë qenë të rregullt Mësimit dhe a kanë ardhur në kohë gjatë ligjëratave e kanë vlerësuar me 4.18. Sa mësimit kanë ardhur të përgatitur në mësim, me

4.11. Ndërsa se a e konsiderojnë se vlerësimi nga ana e mësimit është real kanë vlerësuar me notë 4.29.

Një ngritje në vlerësim shihet në konstatimet 4 dhe 5. Përmes vlerës së mesatares 4.40, studentët tregojnë se profesorët e tyre janë kreativ gjatë mësimit dhe inkurajojnë diskutime dhe aktivitete në klasë. Po ashtu ata shpjegojnë mirë konceptet e reja mësimore(4.49)

Një ulje në vlerësim(3.99) shihet në qëndrimin e studentëve rreth ofrimit të literaturës nga ana e mësimit. (Pohimi 6) . Me mesatare 3.95, studentët kanë vlerësuar edhe mënyrën e vlerësimit të profesorëve të tyre. (Pohimi 8)

Mesatarja e përgjithshme në programin Master është 4.

2.1.2. Qëndrimet e studentëve të UKZ-Së në raport me pohimet e shprehura në pyetësor

Tabela 7. Rezultatet e përgjithshme të vlerësimit të Stafit Akademik të UKZ-së nga ana e studentëve

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Sillabusi i lëndës është prezantuar në fillim të semestrit	4.46
2	Mësimdhënësi /ja ka qenë i rregullt dhe ka ardhur në kohë gjatë ligjëratave	4.34
3	Mësimdhënësi ka ardhur i përgatitur në mësim	4.48
4	Mësimdhënësi/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.22
5	Mësimdhënësi/ja ka shpjeguar mire konceptet e reja	4.43
6	Literatura e ofruar nga mësimdhënësi/ja është e mjaftueshme për përvetësimin e lëndës	4.23
7	Materialet mësimore kanë qenë të dobishme për studimet e mia	4.28
8	Vlerësimi i punës së studentëve është bërë në vazhdimësi	4.11
9	Konsideroj se vlerësimi nga ana e mësimdhënësit është real	4.32
10	Mësimdhënësi/ja ka mbajtur konsultime të rregullta	4.27
Mesatarja e përgjithshme		4.31

Tabela 7.1 Për Asistentë

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Asistenti/ja ka qenë i/e rregullt dhe ka ardhur në kohë gjatë ushtrimeve	4.58
2	Asistenti/ja ka ardhur i/e përgatitur në mësim	4.56
3	Asistenti/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.37
4	Asistenti/ja ka shpjeguar mire konceptet e reja	4.40

5	Materialet mësimore kanë qenë të dobishme për studimet e mia	4.33
6	Vlerësimi i punës së studentëve është bërë në vazhdimësi	4.27
7	Konsideroj se ushtrimet kanë qenë të dobishme për lëndën	4.48
8	Ushtrimet e Asistentit/es janë në përputhje të plotë me ligjëratat e Profesorit	4.48
	Mesatarja e përgjithshme	4.43

Tabela 10 paraqet të dhënat e përgjithshme të gjitha NJ.A., që kooperojnë brenda Universitetit.

Siç shihet, vlerat e shprehura me mesatare tregojnë për një qëndrim pozitiv të përgjithshëm të studentëve ndaj mësimdhënësve të tyre.

Studentët e UKZ-së në masë të madhe kanë konsideruar të vlefshme përgatitjen e mësimdhënësve për ligjëratat,(pohimi 3, mesatarja 4.48)

Gjithashtu studentët me dallime shumë të vogla shprehen se organizimi i mësimin në Universitet është në nivel të kënaqshëm. Rezultatet tregojnë se mësimdhënësit kanë shpërndarë në kohë syllabusin dhe shpjegojnë mirë konceptet e reja mësimore, (mesatarja nga 4.46, 4.43)

Qëndrimi i përgjithshëm i studentëve të UKZ-së tek pohimet 4,6 dhe 8 është i përafërt me qëndrimin e të gjitha Nj. A . Mesataret e këtyre pohimeve tregojnë se studentët janë më pak të kënaqur lidhur me mënyrën e organizimit të mësimin në klasë,(mesatarja 4.22), po ashtu edhe me literaturën të cilën ua ofrojnë mësimdhënësit (Mesatarja 4.23). Një ulje më e theksuar vërehet në pohimin 8 Ku studentët edhe kësaj radhe shprehen më pak të kënaqur lidhur me vlerësimin e punës së tyre në vazhdimësi (Mesatarja 4.11)

Në tabelën 10.1 janë paraqitur rezultatet e përgjithshme të gjitha Fakulteteve për asistentë. Në bazë të dhënave shihet një ngritje në rezultate nga ato për profesor.

Në pohimin 1dhe 2 Studentët mjaft të kënaqur shprehen në ardhjen me kohë të asistentëve gjatë ushtrimeve (Mesatarja 4.58) si dhe përgatitjen e tyre për mësim (Mesatarja 4.56) . Qëndrimet e përgjithshme të studentëve të UKZ-së në raport me pohimet 4, 7, 8 janë të përafërta me dallime të vogla në përqindje, ata shprehen mesatarisht të kënaqur me shpjegimin e koncepteve të reja (4.40) , konsiderojnë të

dobishme ushtrimet me asistentë (4.48) si dhe në masë të madhe vlerësojnë se ushtrimet e asistenteve janë në përputhje më ligjëratat e profesorëve (4.48). Një ulje më e theksuar vërehet edhe tek vlerësimi për asistentë tek pohimi 6, ku studentët janë më pak të kënaqur me vlerësimin e punës së tyre në vazhdimësi nga ana e asistentëve.

3. Përfundimet dhe rekomandimet

Duke u bazuar në të dhënat e këtij hulumtimi si dhe analizën e detajuar të rezultateve mund të konkludojmë se studentët e UKZ-së, në masë të madhe janë të kënaqur me performancën e mësimeve të tyre, këtë e vërteton mesatarja e përgjithshme e cila është 4.31 që do të thotë për 0.02% më e ulët se mesatarja e semestrit të kaluar.

Siç shihet, mesataret e përgjithshme të Nj. A. janë mbi 4. Me mesatare më të lartë për profesor prin Juridiku me 4.39 pastaj radhiten Fakulteti i Shkencave Kompjuterike me 4.37, Fakulteti i Edukimit 4.37 si dhe Fakulteti Ekonomik 4.30. Një mesatare më e ulët vërehet tek Programi Master (E-Qeverisja) rreth 4.15. Ndërsa me mesatare më të lartë për asistentë, prin Juridiku me 4.62, pason nga ai i Edukimit me 4.59, pastaj Ekonomiku me 4.34 si dhe Shkencat Kompjuterike me 4.18.

Qëndrimet e studentëve të shprehura ndaj mësimeve, në të gjitha NJA, pothuajse kryesisht janë të përafërta me ndonjë dallim të vogël në përqindje. Përveç në konstatimin 4,6 dhe 8 ku shkalla e vlerësimit është më e ulët. Sipas rezultateve, metodologjia e re e mësimeve e cila inkurajon diskutime dhe aktivitete në klasë ende le për të dëshiruar (Mesatarja 4.22). Një rezultat më të ultë na ka dhënë konstatimi se literatura e ofruar nuk është në nivel të kënaqshëm sa për të përvetësuar studentët lëndën (4.23). Gjithashtu vlerësimi sistematik i punës së studentëve ende nuk praktikohet nga të gjithë mësimeve të UKZ-së (4.11).

Vlen të theksohet se me një diferencë të dukshme më të lartë se sa profesorët, janë vlerësuar disa nga asistentët e Universitetit në veçanti asistentët e Juridikut.

Nga rezultatet e dala nga ky hulumtim mund të konstatojmë se roli dhe përgjegjësia e mësimeve, qasja e tij në realizimin e plan programit si dhe komunikimi i vazhdueshëm me studentë janë faktor kyç në ngritjen e cilësisë në UKZ. Prandaj rekomandimet e tona janë:

- Të monitorohet në tërësi, për çdo fillim semestri, shpërndarja e syllabusit të lëndëve, në të gjitha programet studimore brenda Universitetit.
- Të sigurohet literatura e duhur për studentë të gjitha programeve studimore në UKZ.
- Të inkurajohen mësuesit për zhvillim të vazhdueshëm profesional sidomos në zbatim të metodologjisë së mësimit.
- Të organizohen trajnime brenda Universitetit me qëllim të përfundimit të metodave dhe formave bashkëkohore të mësimit.
- Të mbikëqyret përputhshmëria e literaturës në plan program me literaturën që e përdorin mësuesit me studentë.
- Mësuesit të përdorin materiale të duhura në realizimin e planprogramit mësimor
- Të konsultohen në mënyrë individuale mësuesit me performancë më të ulët lidhur me praktikën e vlerësimit.
- Të monitorohen rregullisht, konsultimet e profesorëve me studentë si dhe t'u tërhiqet vërejtja mësuesve për këtë çështje.
- Dekanët të vazhdojnë të bëjnë koordinimin e plotë të plan programeve mësimore me kurrikulat e reja.
- Të gjinden forma të motivimit të mësuesve, të cilët kanë treguar performancë të mirë gjatë vlerësimit.